

BULLIZMI KIBERNETIK TE TË RINJTË DHE LIDHJA E TIJ ME CILËSINË E TYRE TË JETËS DHE SHËNDETIN MENTAL



www.ycusmac.org
ycusmac@gmail.com

Botuesi

Këshilli Rinor i Ambasadës së SHBA-së në Maqedoninë e Veriut

www.ycusmac.org
ycusmac@gmail.com

Tekst (analizat)

Sanja Andreevska, Ivana Kitanoviq, Bojan Kitanoviq, Aziz Sulejmani,
Ivan Durgutov, Delijan Uzunov dhe Ardita Vejseli

Lektura

Valentina Joshevska

Dizajni grafik

Këshilli Rinor i Ambasadës së SHBA-së



Publikimi është përgatitur nga ekipi i Këshillit Rinor të Ambasadës së SHBA-së në Maqedoninë e Veriut, me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Maqedoninë e Veriut në kuadër të projektit "Shëndeti mental i të Rinjve në Maqedoninë e Veriut", të realizuar në bashkëpunim me SmartAp – Laboratorin për Inovacione Sociale. Përmbajtja e dokumentit i përket Këshillit Rinor të Ambasadës së SHBA-së në Maqedoninë e Veriut dhe SmartAp – Laboratorin për Inovacione Sociale dhe nuk shpreh qëndrimet e Ambasadës së SHBA-së në Maqedoninë e Veriut apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shkup 2022

Falënderim

Falënderim të madh për profesoreshën Ana Frichand nga Instituti i Psikologjisë i Fakultetit të Filozofisë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodi" – Shkup për mbështetjen e madhe gjatë gjithë procesit, që nga përpilimi i pyetësorit dhe mbledhja e përgjigjeve deri te shkrimi i këtij publikimi.

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
GJENDJA ME BULLIZMIN KIBERNETIK TE TË RINJTË NË MAQEDONINË E VERIUT	9
DISKUTIM DHE KONKLUZIONE	22
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	24
SHTOJCA	25



HYRJE

Sot, pothuajse nuk ka asnjë individ të ri në Maqedoninë e Veriut që nuk e ka marrë pyetjen "Cili është profili yt në Instagram? Do të të ndjek!", e megjithatë nuk mendojnë të gjithë se cili është niveli i sigurisë që e gëzojnë apo e kanë derisa i përgjigjen pyetjes së parashtruar. Jetesa në kohë moderne digjitale, është në fakt e paimagjinueshme për një individ të ri, nëse ai ose ajo nuk është i pranishëm në botën virtuale.

E gjithë kjo është në rregull dhe është e përshtatshme për shoqërinë past-informatike në të cilën gjendemi, ndërsa përfitimet dhe komunikimi i lehtësuar që e sjell interneti, rrjetet sociale dhe në përgjithësi teknologjia informatike janë të padiskutueshme. Në të njëjtën kohë, duhet pranuar se bota digjitale, ndonëse në shikim të parë është vetëm virtuale, i bart me vete rreziqet e njëjta të sigurisë, si edhe bota dhe hapësira fizike.

Një nga rreziqet për të cilat duhet të diskutohet dhe një nga rreziqet që ekziston është bullizmi kibernetik, si term i pranuar për dhunën që ndodh përmes kompjuterëve, telefonave të mençur dhe veglave të tjera bashkëkohore.

Krijimi i identitetit personal onlajn, kryerja e detyrimeve të shumta përmes internetit si pagesa e llogarive dhe faturave të ndryshme, transferimi i mjeteve monetare, marrja e shërbimeve publike nga shteti etj., por edhe kalimi i kohës për shoqërim dhe socializim në hapësirën digjitale, tingëllojnë kaq normale dhe të dëshirueshme, por duhet të diskutohet hapur edhe për rreziqet që mund t'i sjellin.

Ngacmimi, kërcënimi, tallja, gjuha e urrejtjes - të gjitha këto terme janë veçanërisht aktuale dhe të pranishme kur flitet për atë se çfarë do të thotë të flitet, parandalohet dhe mbrohet një individ derisa kalon kohë në hapësirën digjitale.

Ndryshimet që në mënyrë të pashmangshme i solli me vete pandemia shëndetësore e virusit Kovid-19, mes tjerash, shënojnë edhe nevojën për vetëdije edhe më të madhe se shumica e gjërave në fakt mund të bëhen edhe pa prani fizike.

Kjo pandemi ka ngritur në mënyrë plotësuese alarmin për vigjilencë dhe informimin e të gjithë atyre që një pjesë të madhe të kohës së tyre private dhe profesionale e kalojnë virtualisht dhe si rrjedhojë, hulumtimi që vijon synon që të hapë rrjedhën e diskutimit për atë se çfarë është bullizmi kibernetik dhe sa është i rëndësishëm si dukuri.

Shëndeti mental si koncept më i gjerë përfshin edhe rëndësinë e mirëqenies dhe ndjenjës së mirë gjatë "jetesës" në hapësirën që nuk është fizike. Si rrjedhojë, për të rinjtë si pjesa më e digjitalizuar e popullsisë dhe ata që i kushtojnë më së shumti kohë pranisë së tyre virtuale, është e domosdoshme të flitet dhe t'u tregohet për disa nga njohuritë deri te të cilat është ardhur përmes këtij hulumtimi. Duke i dëgjuar dhe analizuar ato, përcillen leksione se si mund të parandalohen pasojat negative të dhunës që karakterizohet si bullizëm kibernetik ose me terminologjinë juridike që është pjesë e të ashtuquajturit "krim kompjuterik".

Bullizmi kibernetik është vazhdimësi e një dukurie shumë të shpeshtë dhe të njohur mirë - atij të bullizmit; sjelljes agresive për të frikësuar, kërcënuar ose turpëruar me qëllim që të lëndohet fizikisht ose emocionalisht viktimja, që mund të ndodhë në çfarëdo vendi, ndërsa për më të rinjtë veçanërisht në mjedise për shoqërim siç janë shkollat, me zgjerimin e vetëm se bullizmi kibernetik ndodh përmes pajisjeve elektronike.

Sot, interneti është pjesë e pazëvendësueshme e përditshmërisë së një të riu në Maqedoninë e Veriut dhe në mbarë botën. Shpërndarja e shfrytëzimit të internetit është tendencë e vazhdueshme, ku 83% e amvisërive në të gjithë territorin kanë qasje në të, që shënon rritje nga një vit më parë (Enti Shtetëror i Statistikës, 2022). Për aq më tepër, duke qenë se bota ishte prekur nga pandemia e Kovid-19, ishte faktor i presionit në rritjen e shfrytëzimit të internetit dhe mediave sociale, meqë masat e mbylljes sollën deri te nxënia përmes internetit/në distancë për nxënësit dhe studentët në mbarë botën.

Pandemia po ashtu shkaktoi rritje globale të ankthit dhe depresionit, me një prevalencë edhe më të lartë tek të rinjtë (OBSH, 2022). Me të vërtetë, kjo situatë e përkeqësoi dukurinë e mirënjohur të bullizmit, të lehtësuar me përhapjen e internetit dhe mediave sociale.

Meqë krimi i bullizmit kibernetik është vepër penale alarmuese me ndikim global, ligjet e miratuara për luftë kundër bullizmit kibernetik janë krejtësisht të paradokohshme. Në vendet ku janë miratuar ligje për bullizëm kibernetik, sjellja virtuale që shkakton tronditje serioze emocionale konsiderohet vepër penale dhe viktimat mund të kërkojnë mbrojtje, ndalim për shfrytëzimin e mediave sociale për autorin, etj. (UNICEF, n.d.).

Në Maqedoninë e Veriut, ku ende nuk janë miratuar ligje të përgatitura në mënyrë speciale për bullizmin kibernetik, institucionet shtetërore mbështeten në ligje të tjera për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë edhe krimin në internet (UNICEF, n.d.).

Problemi tjetër me mediat sociale, siç është rasti me Fejsbukun, është se ekziston mospërputhje në përpunimin e abuzimeve të denoncuara, meqë ndonjëherë gjuha në të cilën ndodh abuzimi është e ndryshme nga anglishtja, veçanërisht për arsye se mediat sociale kanë arritur në çdo cep të botës dhe çdo gjuhë.¹

Më tutje, bullizmi kibernetik është i pranishëm në çfarëdo hapësirë, madje edhe kur dikush është në shtëpi, pa e vërejtur askush nga rrethina dukurinë që ndodh. Element plotësues në bullizmin kibernetik është fakti se interneti mund të sigurojë anonimitetin dhe materialet që janë postuar fshihen ose mënjanohen vështirë nga bota virtuale, gjë që sjellë ndikim afatgjatë në shëndetin mental të viktimave.

Efektet në shëndetin afatgjatë mental e të rinjve janë ato që duhet të alarmojnë jo vetëm për veprim institucional për të parandaluar këtë sjellje agresive dhe të dëmshme, por edhe për shoqërinë tonë.²


Pas vargut të aktiviteteve që synojnë ngritjen e vetëdijes për shëndetin mental te të rinjtë e përfshirë në kohë të pandemisë, Këshilli Rinor i Ambasadës së SHBA-së në Shkup, pas

¹<<https://www.reuters.com/article/us-facebook-languages-insight-idUKKCN1RZ0DW>>

²<<https://www.stopbullying.gov/blog/2016/10/27/law-enforcements-reminder-negative-effects-cyberbullying-and-what-we-can-do-prevent-it>>

hulumtimeve, vendosi t'i qaset kësaj teme të re për të cilën flitet pak - bullizmit kibernetik. Përdorimi i rritur i internetit, mundësitë për rritjen e bullizmit kibernetik, si dhe ndikimi në shëndetin mental ishin motiv për këtë hulumtim.

Publikimi është i ndarë në 4 pjesë. Pjesa e parë jep pasqyrë të situatës me bullizmin kibernetik në Maqedoninë e Veriut. Pjesa e dytë përfshin metodologjinë dhe mënyrën se si janë mbledhur të dhënat. Pjesa e tretë ka të bëjë me analizën e të dhënave të marra nga pyetësi. Në pjesën e katërt jepet konkluzion dhe rekomandime.



GJENDJA ME BULLIZMIN KIBERNETIK TE TË RINJTË NË MAQEDONINË E VERIUT

Sa i përket gjendjes me bullizmin kibernetik te të rinjtë në Maqedoninë e Veriut, nuk u has asnjë literaturë shkencore, e as, nga ana tjetër, statistikë konkrete nga një institucion i caktuar shtetëror që mund të shfrytëzohet në mënyrë që të vendoset ndonjë prag në bazë të të cilit do të bëhet krahasimi nëse situata e bullizmit kibernetik është përmirësuar ose përkeqësuar. Megjithatë, është bërë përpjekje për të gjetur të gjitha aktivitetet e zbatuara në këtë temë për ngritjen e vetëdijes për dhunën kibernetike, të cilat janë dhënë në shtojcë. Ky publikim paraqet hulumtimin e parë të këtij lloji në Maqedoninë e Veriut.

1. Metodologjia

Instrumenti matës

Hulumtimi është bërë në mënyrë elektronike, duke dhënë pyetësor që pjesëmarrësit e plotësonin në mënyrë anonime. Kjo mënyrë e hulumtimi është zgjedhur për arsye se ishte e nevojshme të përfshihet grup më i madh i pjesëmarrësve për periudhë relativisht të shkurtër, ndërsa kjo metodë është dëshmuar si efikase në rast të këtilla³. Përmes pyetësorit mund të merren informacione specifike nga ky grup më i madh, të analizohen dhe të miratohen konkluzione përkatëse. Pikërisht kjo metodë ishte e nevojshme për këtë hulumtim, në të cilin qëllimi është të përfshihen disa kategori të të rinjve.

Përgatitja e pyetësorit përfshin disa hapa. Së pari, është bërë studim për hulumtimet dhe literaturën ekzistuese në dhe jashtë Maqedonisë së Veriut. Më pas, pyetësori u përpilua në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare për këtë lloj të hulumtimeve, derisa nga ana tjetër, pyetjet ishin të konstruara me shfrytëzimin e pyetësorëve tashmë të definuar që janë përdorur jashtë Maqedonisë së Veriut duke i përshtatur ato ose duke shtuar pyetje në konsultim me ekspertët maqedonas. Për përpilimin e pyetësorit gjithashtu është konsultuar ekspert dhe profesor nga Maqedonia e Veriut me qëllim që të përmirësohet pyetësori.⁴

Pyetësori është shpërndarë në mënyrë elektronike në rrjetet sociale dhe ueb-faqen e Këshillit Rinor të Ambasadës së SHBA-së dhe u është dërguar organizatave rinore, shkollave të mesme dhe fakulteteve. Pyetësori ishte i hapur për t'u plotësuar gjatë periudhës nga shkurti deri në qershor të vitit 2022.

³<https://www.snapsurveys.com/blog/4-main-benefits-survey-research>

⁴https://mro.massey.ac.nz/bitstream/handle/10179/5130/02_whole.pdf

Pyetëtori përmban zgjedhje të detyruara (pyetje PO/JO) dhe pyetje me më shumë zgjedhje. Në këtë mënyrë u mundësohet të anketuarve që t'u përgjigjen pyetjeve më shpejt dhe më lehtë dhe të rrumbullakojnë më shumë gjëra që u interesojnë, e që më pas do të ishin më të dobishme për analizën sesa të zgjidhet vetëm një përgjigje.

Vlen të përmendet se pyetëtori është spastruar nga përgjigjet e palogjikshme të pjesëmarrësit, meqë vështirë mund të interpretohen gjetjet. Është e mundur që pjesëmarrësi të mos e ketë lexuar mirë pyetjen ose të mos e ketë kuptuar, ose ndoshta edhe u është përgjigjur pyetjeve në mënyrë automatike.

Pyetëtori përbëhet nga 4 pjesë. Pjesa e parë jep sqarim të hollësishëm se çfarë është bullizmi kibernetik me qëllim që pjesëmarrësit të njoftohen me konceptin dhe qëllimin e hulumtimit.

Pjesa e dytë ka të bëjë me të dhënat demografike për pjesëmarrësit. Këto të dhëna shërbejnë për t'u njoftuar me karakteristikat e të anketuarve, si gjinia dhe përkatësia etnike dhe për të parë nëse ka ndonjë mospërputhje në të dhënat. Po ashtu, jepet informacion për reprezentativitetin e të dhënave.

Pjesa e tretë përmban pyetje që kanë të bëjnë me procesin e bullizmit kibernetik. Nëpërmjet këtyre pyetjeve, qëllimi është që të kuptohen format dhe mënyrat në të cilat kjo manifestohet te të rinjtë dhe cilat janë mendimet e tyre në raport me intensitetin e bullizmit kibernetik para pandemisë dhe gjatë pandemisë. Po ashtu, në këtë pjesë shqyrtohet edhe nëse ka "dhunues të fshehur" në mesin e të anketuarve, respektivisht persona të cilët me ose pa vetëdije bëjnë bullizëm kibernetik.

Pjesa e katërt përfshin çështje përmes të cilave mund të mësohet lidhja e bullizmit kibernetik me shëndetin mental e të rinjve. Përmes pyetjeve për atë se si janë ndier nëse kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik, a kanë mbështetje dhe si e vlerësojnë ndikimin e bullizmit kibernetik, merren informacione për atë nëse dhe sa ndikim ka bullizmi kibernetik në shëndetin mental e të rinjve.

Nga shëndeti mental në masë të madhe varet funksionimi dhe sjellja normale e tyre brenda dhe jashtë shkollës, gjë që është tregues i mjaftueshëm se pse atij duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe.

Pjesëmarrësit

Grupi qëllimor i hulumtimit janë të rinjtë e moshës nga 15 deri 29 vjeç nga të gjitha rajonet dhe nacionalitetet në shtet. Pjesëmarrja në pyetëtorin ishte krejtësisht vullnetare dhe anonime.⁵

Pyetjeve iu përgjigjën të gjithë pjesëmarrësit, respektivisht pjesëmarrësit që kanë qenë dhe nuk kanë objekt i bullizmit kibernetik, meqë ka pyetje që kanë të bëjnë me situatat që kanë ndodhur, por ka edhe pyetje "ÇKA/NËSE". Përveç kësaj, numri i përgjithshëm i përgjigjeve të disa pyetjeve dallon për shkak të refuzimit të pjesëmarrësve që t'u përgjigjen këtyre pyetjeve.


⁵ Sipas nenit 3 të Ligjit të Pjesëmarrje Rinore dhe Politika Rinore, të rinj janë personat nga 15 deri në 29 vjeç.

Është e rëndësishme të theksohet se pyetësoi është spastruar dhe janë përjashtuar pjesëmarrësit që janë jashtë kësaj grup-moshe, si dhe përgjigjet që nuk janë në përputhje me atë që është shkruar. Gjithashtu, ata pjesëmarrës të cilët janë përfshirë në analizën besohet se japin përgjigje të sinqerta dhe të sakta.

2. Rezultatet


Analizë e të dhënave demografike

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të cilët morën pjesë në plotësimin e pyetësoit është 332, nga të cilët 73.5% janë të gjinisë femërore dhe 22.9% janë të gjinisë mashkullore (grafiku 1).



Grafiku 1. - Paraqitja e ekzemplarit sipas gjinisë

Sipas shkallës së arsimit të pjesëmarrësve, përqindja më e lartë e tyre janë shkollarë (49.1%), të pasuar nga studentët e studimeve para diplomimit (38.6%). Përveç kësaj, nga pjesëmarrësit në pyetësoin ka edhe të diplomuar (4.2%), studentë të studimeve të magjistraturës (3.3%), dhe tashmë studentë me magjistraturë (2.7%). Këto të dhëna janë paraqitur në grafikun 2.




Grafiku 2. - Paraqitje e ekzemplarit sipas shkallës së arsimit


Sipas statusit të punës, 287 nga pjesëmarrësit janë persona të punësuar ndërsa 45 janë persona të papunë.

Sa i përket vendbanimit, me hulumtimin janë përfshirë të rinj nga disa rajone të shtetit, për shkak të reprezentimit dhe përvojave më të mëdha. Megjithatë, në përputhje me të dhënat e paraqitura në grafikun 3, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në pyetësorin janë nga Shkupi ose Rajoni i Shkupit (105 pjesëmarrës), të pasuar nga Manastiri (32 pjesëmarrës), Struga (20 pjesëmarrës), Kumanova (19 pjesëmarrës), Prilepi (16 pjesëmarrës), Ohri (15 pjesëmarrës).

Sipas përkatësisë etnike, pjesëmarrësit janë deklaruar 77,7% maqedonas, 15,1% shqiptarë, 1,5% romë, 1,5% serbë, 1,2% turq, 1,2% vllahë, 0,9% boshnjakë dhe nacionalitete të tjera, në mesin e të cilëve edhe grekë dhe torbeshë (grafiku 4).



Grafiku 3. - Paraqitje e ekzemplarit sipas vendbanimit




Grafiku 4. - Paraqitje e ekzemplarit sipas përkatësisë etnike



Në pjesën e dytë të pyetësorit, theksi kryesor është vënë në procesin e bullizmit kibernetik, respektivisht se si ndodh bullizmi kibernetik dhe si janë të lidhura me të mediat sociale.


Pyetja e parë është “A përdorni rrjete sociale?”, të cilës të gjithë 332 pjesëmarrësit i janë përgjigjur pozitivisht. Kjo e dhënë nuk është befasuese, duke marrë parasysh se të rinjtë jetojnë në një kohë ku rrjetet sociale janë pjesë e rëndësishme e jetës së tyre. Pyetja e dytë ka të bëjë me atë se në cilat rrjete sociale të rinjtë e kalojnë kohën e lirë. Në mesin e rrjeteve më të njohura sociale në të cilat të rinjtë kalojnë kohën e lirë, veçohen Instagrami dhe YouTube. Në Grafikon 5 shihen qartë rrjetet më të përdorura sociale të përmendura nga pjesëmarrësit.



Grafiku 5. - Paraqitje e ekzemplarit sipas rrjeteve më të përdorura sociale

Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, 329 përdorin rrjete sociale çdo ditë, vetëm njëri i përdor çdo të dytën ditë dhe dy persona i përdorin një herë në javë.

Në raport me të anketuarit që janë përgjigjur se i përdorin rrjetet sociale çdo ditë, thuajse gjysma e tyre i përdorin më shumë se tre orë në ditë, e 26% i përdorin tre orë (grafiku 6). Maqedonia e Veriut nuk ka në dispozicion statistikë se sa kohë kalojnë në rrjetet sociale të rinjtë që kanë qenë objekt i bullizmit kibernetik ose janë në depresion.



Grafiku 6. - Paraqitje e ekzemplarit sipas orëve të kaluara në rrjetet sociale


Megjithatë, disa hulumtime kanë arritur në konkluzionin se ekziston lidhje e fortë mes kohës së kaluar në rrjetet sociale dhe rritjes së nivelit të depresionit, ankthit, vetmisë etj..⁶

Sipas revistës për psikologji sociale dhe klinike, kufizimi i kohës së kaluar në rrjetet sociale në 30 minuta shpie drejt shëndetit më të mirë mental dhe ndikimit pozitiv në shëndetin e përgjithshëm të njeriut.⁷


Më pas, të rinjtë janë përgjigjur nëse te ata në shkollë dhe/ose fakultet bisedohet për bullizmin kibernetik me qëllim që të shihet se sa janë të njoftuar me këtë dukuri dhe nëse atij i kushtohet vëmendje. Me këtë rast, te 65.4% e të anketuarve nuk bisedohet për këtë temë, ndërsa 34.6% thonë se bisedohet (grafiku 7).

Kjo bën të ditur se është e nevojshme që më shumë dhe më shpesh të ngrihet vetëdija për këtë dukuri në arsimin e mesëm dhe atë të lartë.

Grafiku 7. - Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj nëse bisedohet për bullizmin kibernetik



Në lidhje me faktin nëse të njohurit apo miqtë e tyre kanë qenë në shënjestër të bullizmit kibernetik, numri më i madh i të anketuarve ose 42,2% kanë dhënë përgjigje pozitive, 23,8% janë përgjigjur negativisht dhe pjesa tjetër janë shprehur se nuk e dinë (grafiku 8).



Grafiku 8. – Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj nëse ndonjë shok/shoqe ka qenë në shënjestër të bullizmit kibernetik


Sipas të rinjve, mënyrat më të shpeshta në të cilat manifestohet bullizmi kibernetik te moshatarët e tyre janë dërgimi i mesazheve ngacmuese në Messenger/ Viber/ Whatsapp/ Instagram, postimi i komenteve ofenduese në rrjetet sociale, postimi i përmbajtjeve ofenduese në rrjetet sociale dhe dërgimi i kërcënimeve për dëmtim fizik në Messenger/ Viber/ Whatsapp/ Instagram. Kjo tregon se në pjesën më të madhe, bullizmi kibernetik

⁶<https://www.helpguide.org/articles/mental-health/social-media-and-mental-health.htm>

⁷<https://guilfordjournals.com/doi/abs/10.1521/jscp.2018.37.10.751>

ndodh në rrjetet sociale, e është më pak i shpeshtë përmes porosive SMS dhe metodave të ngjashme.


Në raport me faktin nëse ata vetë kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik në gjashtë muajt e fundit, 60.2% nuk kanë qenë dhe 39.8% kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik, gjë që bën të ditur në përqindjen e lartë të të rinjve që përballen me bullizmin kibernetik (Grafiku 9).



Grafiku 9. - Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj se sa nga të anketuarit kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik


Lidhur me këtë, ata që kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik në të shumtën e rasteve kanë marrë përmbajtje që bëjnë të ditur në bullizëm kibernetik gjatë mësimit në shkollë/fakultet dhe para dhe pas mësimit (Grafiku 10).

Ndonëse pjesa më e madhe e këtyre personave nuk donin të tregonin se sa shpesh kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik, nga ata që kanë treguar, te 14.8% ka ndodhur një ose dy herë në gjashtë muaj, ndërsa te 3.3% ka ndodhur dy ose tre herë në muaj.



Grafiku 10. - Paraqitje e ekzemplarit sipas periudhës së marrjes së përmbajtjeve që bëjnë të ditur për bullizëm kibernetik


Më tutje, mendimet e të rinjve janë të ndara në raport me atë nëse bullizmi kibernetik është bërë më i shpeshtë gjatë pandemisë. Për 45.2% të tyre, gjendja nuk ka ndryshuar dhe është e njëjtë si para pandemisë, derisa 44.0% konsiderojnë se bullizmi kibernetik është bërë më i shpeshtë gjatë pandemisë (grafiku 11). Kjo është e kuptueshme nëse merret parasysh se në pandeminë u shpeshtua përdorimi i pajisjeve digjitale, përmes të cilave ndodh më shpesh bullizmi kibernetik.



Grafiku 11. - Paraqitje e ekzemplarit sipas shpeshësisë së bullizmit kibernetik gjatë pandemisë


Të rinjtë të cilët kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik kanë marrë më së shumti porosi shqetësuese në Messenger/Viber/Whatsapp/Instagram, më pas përdorues të tjerë kanë postuar komente, foto dhe video ofenduese për ta në rrjetet sociale, ndërsa kanë marrë edhe kërcënime për lëndim fizik dhe SMS porosi shqetësuese.

Si lloje të përmbajtjeve të padëshiruara që u janë dërguar, 30.9% e të anketuarve identifikojnë gënjeshtër, thashetheme, porosi ofenduese dhe të pakëndshme për ta që u janë dërguar personave të tjerë, 29.7% janë shprehur se ato kanë qenë porosi që shprehin nervozë, vrazhdësi dhe keqdashje, ndërsa 12.9% kanë marrë porosi të shpeshta gjatë javës ose muajit që kanë bërë të ndjehen të frikësuar dhe të shqetësuar (grafiku 12).



Grafiku 12. - Paraqitje e ekzemplarit sipas llojeve të përmbajtjeve të padëshiruara


Në pyetën nëse kanë mësuar se cili/cila ka qenë dhunuesi/dhunuesja, madje 55.4% janë përgjigjur se kanë mësuar, ndërsa 33.1% se nuk kanë mësuar. Pjesa tjetër nuk kanë dashur të tregojnë (grafiku 13).



Grafiku 13. - Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj nëse e kanë mësuar identitetin e dhunuesve


41,7% e këtyre personave kanë mësuar se kush janë dhunuesit meqë ata nuk janë fshehur, 17,7% përmes shokëve/shoqeve dhe 15,6% e kanë gjetur identitetin e tyre në internet.

Kur kanë mësuar se janë shënjestër e bullizmit kibernetik, 21.5% kanë ndërmarrë masa sigurie si bllokim të numrit/profilin, ndryshim të fjalëkalimit dhe denoncim në organet kompetente, 20.6% u kanë treguar shokëve/shoqeve të tyre më të mirë/mira, ndërsa 14% u kanë treguar prindërve/ kujdestarëve. Kishte edhe të tillë (12.3%) që u kanë dërguar porosi dhunuesve që të mos sillen në atë mënyrë (grafiku 14).



Grafiku 14. - Paraqitje e ekzemplarit sipas masave që janë ndërmarrë kur është mësuar se cilët janë dhunuesit

Të anketuarit janë përgjigjur edhe se me kë do të kontaktonin për ndihmë nëse do të ishin shënjestër e bullizmit kibernetik. Shumica prej tyre janë përgjigjur se do t'u drejtoheshin prindërve/kujdestarëve, të pasuar nga shokët/shoqet e tyre më të mirë/mira. Në vend të tretë do të ishte policia, tek pastaj shërbimi profesional në shkollë, psikoterapistët dhe mësime dhënësit/mësimdhënëset ose profesorët/profesoreshat (grafiku 15).



Grafiku 15. - Paraqitje e ekzemplarit sipas personave që do t'i kontaktonin për ndihmë nëse do të ishin shënjestër e bullizmit kibernetik


Kjo tregon se është e nevojshme të punohet në rritjen e besimit e të rinjve në shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë kur bëhet fjalë për këtë problem, veçanërisht meqë siç është paraqitur më lart, përmbajtjet që bëjnë të ditur në bullizmin kibernetik në të shumtën e rasteve janë marrë gjatë mësimit në shkollë/fakultet.

Lidhur me këtë, të rinjtë janë përgjigjur nëse u kanë treguar shokëve të tyre më të mirë, e jo personit të rritur, pse e kanë bërë këtë. Edhe pse shumica kanë deklaruar se kjo nuk ka të bëjë me ta (59.3%), shumica e atyre me të cilët ka të bëjë kjo (18%) e kanë bërë këtë meqë nuk kanë besuar se duke i treguar një personi të rritur do të ndalet bullizmi kibernetik, më pas personi i rritur ndoshta do të kishte reaguar në mënyrë të tepruar dhe do t'i akuzonte ata (16.3%), ndërsa një numër i madh (11.4%) janë shprehur se kanë menduar se shokët do t'u ndihmonin më shumë sesa të rriturit, se personi i rritur do t'u kishte treguar personave të tretë pa lejen e të anketuarve (10.8%) dhe se nuk kanë dashur të fusin njerëz të tjerë në telashe (10.2%).

Nëse, nga ana tjetër, nuk i kanë thanë askujt se kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik, pjesa më e madhe e të anketuarve që janë shprehur se kjo ka të bëjë me ta, kanë vepruar kështu meqë kanë konsideruar se nëse i tregojnë dikujt kjo nuk do t'u ndihmonte (10.5%), nuk kanë ditur kujt t'i kërkojnë ndihmë (9%), nuk kanë dashur të dihet se janë shënjestër e bullizmit kibernetik ose kanë pasur turp të flasin për problemin e tillë (7.5%).

Në kuadër të hulumtimit, qëllimi është edhe që të identifikohet nëse në mesin e të anketuarve ka “dhunues të fshehur”, respektivisht të rinj të cilët me apo pa vetëdije lëndojnë moshatarët e tyre.


Prandaj, ata janë pyetur nëse kanë shkruar porosi apo koment në rrjet social që ka shkaktuar shqetësim te pranuesi, ose nga ana tjetër, nëse i kanë dërguar fotografi një personi tjetër pa pëlqimin e tij/saj. Edhe pse pjesa më e madhe (83.1%) janë përgjigjur se nuk e kanë bërë këtë asnjëherë, megjithatë ka të tillë që e kanë bërë këtë një herë (9.9%) dhe ndonjëherë (5.7%).



Grafiku 16. - Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj nëse kanë shkruar porosi ose koment në ndonjë rrjet social që ka shkaktuar ndjenja të pakëndshme te pranuesi ose nga ana tjetër i kanë dërguar fotografi një personi tjetër pa pëlqimin e tij


Pjesa më e madhe e atyre që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e mëparshme (75.9%) nuk i kanë dërguar përmbajtjet në mënyrë që të lëndojnë individin. Por, 24.1% janë përgjigjur se e kanë bërë me qëllimin që të lëndojnë pranuesin (grafiku 16).

Në raport me përmbajtjen në porositë e dërguara, në të shumtën e rasteve ato kanë qenë porosi zemërimi dhe ofenduese, porosi private ose fotografi të dërguara pa pëlqimin e personit dhe prezantim i rrejshëm në emër të dikujt tjetër (grafiku 17).



Grafiku 17. - Paraqitje e ekzemplarit sipas përmbajtjes së porosive

Inkurajuese është ajo se në pyetjen, nëse dërgojnë porosi ofenduese dhe shqetësuese kur janë vetëm apo me shokët, pjesa më e madhe e të anketuarve (94%) janë përgjigjur se nuk dërgojnë porosi të tilla. Por, nga 3% e të anketuarve janë përgjigjur se dërgojnë porosi të tilla kur janë vetëm ose me shokë.



Grafiku 18. - Paraqitje e ekzemplarit sipas asaj nëse dërgojnë porosi ofenduese dhe shqetësuese kur janë vetëm ose me shokë

Nga ata që dërgojnë porosi që mund të shqetësojnë dikë, 18.4% janë përgjigjur se asnjëherë nuk e fshehin identitetin, ndërsa 3.9% e fshehin ndonjëherë.

E gjithë kjo bën të ditur se bullizmi kibernetik si dukuri komplekse mund të shqyrtohet nga disa aspekte. Pikërisht për këtë arsye të rinjtë duhet të njoftohen më hollësisht me këtë temë, si dhe me të gjitha mënyrat se si manifestohet, në mënyrë që të dallojnë nëse janë shënjestër, ose nga ana tjetër, u bëjnë bulling kibernetik bashkënxënësve të tyre.




Analizë e ndërlidhjes së bullizmit kibernetik me shëndetin mental e të rinjve

Pas njohurive që janë marrë për situatën me bullizmin kibernetik tek të rinjtë, kalohet drejt analizës së ndërlidhjes së bullizmit kibernetik me shëndetin e tyre mental.


Të rinjtë që kanë qenë objekt i bullizmit kibernetik kanë ndier më së shumti ankth, por edhe nervozë.

Thuajse 60% e të anketuarve janë përgjigjur se dhuna kibernetike ka ndikuar në shëndetin e tyre mental. 50% e tyre e kanë konsideruar këtë shumë negative, 26% deri diku negative, 8% pak negative, derisa nga ana tjetër, pjesa e mbetur nuk mund të vendosnin (grafiku 19).




Grafiku 19. - Paraqitje e ekzemplarit sipas ndikimit në shëndetin mental të atyre që kanë qenë shënjestër të bullizmit kibernetik

Në raport me mbështetjen që e kanë të rinjtë gjatë përballjes me shëndetin mental si pasojë e bullizmit kibernetik, rreth 50% e të anketuarve janë përgjigjur se e kanë, 20% janë shprehur se nuk e kanë, e nga ana tjetër, pjesa e mbetur nuk kanë qenë të sigurt (grafiku 20).



Grafiku 20. - Paraqitje e ekzemplarit sipas shkallës së mbështetjes për ruajtjen e shëndetit mental

Të anketuarit, si rezultat i bullizmit kibernetik, janë përballur më së shumti me problemet si vijon: ndjenjë të nervozizmit, ankthit ose tendosjes, probleme me relaksim dhe pamundësinë për të ndaluar shqetësimet ose nga ana tjetër, për të kontrolluar shqetësimin (grafiku 21).



Grafiku 21. - Paraqitje e ekzemplarit sipas problemeve si rezultat i bullizmit kibernetik



DISKUTIM DHE KONKLUZIONE

Bullizmi kibernetik manifestohet në forma të ndryshme derisa të rinjtë janë në hapësirën virtuale. Në të shumtën e rasteve, kjo përfshin dërgimin e porosive shqetësuese, postimin e komenteve dhe përmbajtjeve ofenduese në mediat sociale dhe dërgimin e porosive me kërcënim për lëndim fizik. Duke marrë parasysh se të gjithë të anketuarit në këtë hulumtim përdorin rrjete sociale dhe pjesa më e madhe e moshatarëve të tyre u bashkëngjiten, keqpërdorimi i tyre për të lënduar ndonjë individ bëhet i lehtë.

Me fjalë të tjera, bullizmi kibernetik është shpeshtuar sot dhe përfshin aktivitete të ndryshme në hapësirën digjitale përmes të cilave mund të lëndohet një individ dhe të dëmtohet shëndeti i tij mental. Dhunuesit kibernetikë, në numrin më të madh të rasteve, janë individë të njohur për viktimat dhe që në të shumtën e rasteve nuk e fshehin identitetin e tyre. Sipas të anketuarve në këtë hulumtim, të rinjtë që kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik kanë ndërmarrë masa të sigurisë si bllokim të numrit/profillit, ndryshim të fjalëkalimit dhe denoncim te organet kompetente, u kanë treguar shokëve/shoqeve të tyre më të mirë/mira, ose prindërve/kujdestarëve. Këto masa mund të mos i anulojnë pasojat e këtyre implikimeve, por ato janë një hap përpara drejt përballjes me këtë problem.

Edhe pse bullizmi kibernetik është problem i shumanshëm, qëllimi kryesor i tij është të lëndohet ndonjë individ. Pikërisht për këtë arsye duhet pranuar serioziteti dhe ndikimin e tij negativ që ka në shëndetin mental e të rinjve. Problemet më të shpeshta që shfaqen te viktimat janë ndjenjat e nervozizmit, ankthit ose tendosjes, problemet me relaksim dhe pamundësia për të ndaluar shqetësimet ose për të kontrolluar shqetësimin.

Si rezultat i kësaj, te këta persona shfaqen pasiguri dhe drojë dhe fillojnë të dyshojnë në vetveten dhe në vlerën e tyre. Gjithashtu, shqetësimin e ul paqjen e tyre e brendshme dhe ndikon në rezultatet e tyre në procesin arsimor. Përveç kësaj, bullizmi kibernetik dëmton reputacionin e individit.

Ky hulumtim sjell konkluzion të dyfishtë. Nga njëra anë, të rinjtë në Maqedoninë e Veriut bisedojnë pak për bullizmin kibernetik, e nga ana tjetër, më pak se 50% shprehen se nuk kanë qenë shënjestër e bullizmit kibernetik, gjë që jep një drejtim për të menduar se është e nevojshme të rritet vetëdija për atë se çfarë është bullizmi kibernetik dhe kur dhe si mund të manifestohet.

Në raport me reduktimin e kësaj dukurie, ka disa mënyra që mund të merren parasysh. Së pari, qëkur do të hyjnë në botën digjitale, fëmijët dhe të rinjtë duhet të mësohen për sigurinë në internet dhe të mos shpërndajnë informacione personale onlajn. Në këtë mënyrë ata do të zvogëlojnë mundësinë për të qenë të vërejtur nga dhunuesi kibernetikë të cilët nuk do të kenë çfarë të përdorin kundër tyre.

Lidhur me këtë, të rinjtë duhet të evitojnë fotografi dhe informacione personale onlajn dhe të kenë kujdes se cilët i kanë miq dhe ndjekës në rrjetet sociale. Mospranimi i përdoruesve që nuk i njohin personalisht mund të ndihmojë. Ata gjithashtu duhet të përpiqen të komunikojnë onlajn me grup të shokëve të cilëve u besojnë. Edhe një aspekt shumë i rëndësishëm është që të mos ndajnë publikisht fjalëkalime dhe detaje të tjera që lidhen me profilet e tyre.

Gjithashtu, prindërit duhet të flasin hapur për bullizmin kibernetik si dukuri dhe t'u tregojnë se çfarë paraqet ai dhe si manifestohet. Kështu, do të mund ta dallojnë atë menjëherë dhe të përpiqen të mbrohen prej tij.

Krahas kësaj, nevojitet edukim më i madh, fillimisht mes stafit mësimdhënës dhe shkollor, me rritjen e besimit të të rinjve ndaj tyre, meqë të rinjtë më së paku do t'u kishin treguar atyre nëse janë shënjestër e bullizmit kibernetik.

Nga e gjithë kjo mund të përfundohet se vetëdija është kyçe për reduktimin e bullizmit kibernetik. Sa më herët që të rinjtë do të mësojnë të jenë të kujdesshëm dhe të sillen me kujdes dhe me përgjegjësi në rrjetet sociale, aq më mirë.

Si hapa të ardhshëm që duhet të bëhen në lidhje me këtë temë do të ishin ngritja aktive e vetëdijes si dhe edukimi më i madh për ndërmarrjen e masave të sigurisë në rast të bullizmit kibernetik. Më e rëndësishme se gjithçka është ndërmarrja e veprimeve nga institucionet kompetente shtetërore dhe organizatat joqeveritare me qëllim që të kuptohet dhe përmirësohet mirëqenia te të rinjtë.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Campfield, CD, (2008). Cyber Bullying and Victimization: Psychosocial Characteristics of Bullies, Victims, and Bully/Victims.
2. Harrison, M, G., (2013). Should I Tell on My Peers? Student Experiences and Perceptions of Cyberbullying.
3. Lawler, P, J., & Molluzzo, C, J., (2015). Student Experiences and Perceptions of Cyberbullying.
4. Hamburger ME, Basile KC, Vivolo AM (2011). Measuring Bullying Victimization, Perpetration, and Bystander Experiences: Measuring Bullying Victimization, Perpetration, and Bystander Experiences: Atlanta, GA: Measuring Bullying Victimization, Perpetration, and Bystander Experiences:

Linqet:

1. <<https://www.stat.gov.mk/publikacii/2022/MK-brojki-2022-mk.pdf>>
2. <<https://www.unicef.org/northmacedonia/mk/cajber-silecistvo-shto-pretstavuva-i-kako-da-se-zagre>>
3. <<https://www.who.int/news/item/02-03-2022-covid-19-pandemic-triggers-25-increase-in-prevalence-of-anxiety-and-depression-worldwide>>
4. <<https://www.reuters.com/article/us-facebook-languages-insight-idUKKCN1RZ0DW>>
5. <<https://www.stopbullying.gov/blog/2016/10/27/law-enforcements-reminder-negative-effects-cyberbullying-and-what-we-can-do-prevent-it>>

SHTOJCA

Në këtë shtojcë është dhënë pasqyrë e shkurtër e të gjitha aktiviteteve që janë ndërmarrë nga institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare ose individët në temën e bullizmit kibernetik.

- Asociacion ose shoqatë për bullizëm kibernetik/shëndet mental

Nuk ka asociacion që mbulon këtë domen. Në përgjithësi ka projekte nga donatorë të huaj që mbulojnë këtë temë.

- Ekziston Shtëpi e shëndetit Shkup - Enti për shëndet mental të fëmijëve dhe të rinjve - Mlladost. Ajo nuk ka asnjë ueb-faqe apo media sociale, mund ta gjeni vetëm numrin e tyre të telefonit përmes Librit të artë: Telefoni 1: 02 3068307; Telefoni 2: 02 3065711.
- Ekziston [Shërbimi këshillues për të drejtat e të rinjve](#) ku kanë publikuar përgjigje dhe pyetje për këtë temë.
- Ekziston një *Facebook Community* që ka punuar në këtë temë – [Dhuna kibernetike – edhe kjo është dhunë](#). Sipas aktivitetit nga ana e tyre, mund të vërehet se para nxënësve janë mbajtur ligjërata në këtë temë. Megjithatë, postimi i fundit në ueb-faqen daton nga 30 maji i vitit 2019, gjë që bën të ditur se aktualisht nuk është aktive.
- Aktivitete të institucioneve publike të lidhura me bullizmin kibernetik
 - Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka realizuar aktivitete të caktuara në temën e bullizmit kibernetik. Me fjalë të tjera, Agjencia organizon ngjarje çdo vit me rastin e Ditës së internetit të sigurt.

Fragment nga ueb-faqja e tyre:

“Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale më 8 shkurt të vitit 2022 organizoi ngjarje onlajn në gjuhën maqedonase dhe shqipe në temën "Si të argëtoheni dhe të luani në mënyrë të sigurt onlajn". Në këtë ngjarje morën pjesë aktive nxënës nga klasa e IV dhe V të disa shkollave fillore nga shteti”.

Me rastin e Ditës së Internetit të Sigurt, Agjencia në bashkëpunim me tuining projektin e BE-së "Mbështetje në zbatimin e kornizës së modernizuar ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale" përpiloi informator në temën "Privatësia e fëmijëve dhe të rinjve në botën e teknologjive moderne (internet dhe rrjete sociale)". Në këtë ngjarje u promovua videoja edukative për "Dhunën onlajn".

[Shënohet Dita e internetit të sigurt | Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale \(dzlp.mk\)](#)

- Në [raportin](#) e Projektit të BE-së në Maqedoninë e Veriut - „Sustainable System For Continuous Primary And Secondary Education For Principles Of Personal Data Protection“, është përmendur se Agjencia për Mbrojtjen e Të dhënave Personale, së bashku me fondacionin Metamorfozis ka zbatuar aktivitetin CRISP (Children’s Rights on the Internet – Safe and Protected) - me qëllim që të sigurohet mbrojtje më e madhe e të drejtave të fëmijëve në internet. Si pjesë e aktivitetit u krijua ueb-faqja - crisp.org.mk për të kontribuar në sigurinë më të madhe dhe mbrojtjen e të drejtave dhe privatësisë së fëmijëve në internet. Njëherësh, një nga arsyet e përmendura në raportin për implementimin e këtij aktiviteti është edhe **dhuna kibernetike**:

„The children can become victims of cyber bullies that tend to confuse and scare them by using the internet, and later on they can also be subject to abuse, or even physically and psychically violated..“ - fragment nga raporti.

- Në nivel të Komunës së Karposhit, e në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike, janë mbajtur ligjërata të caktuara për sigurinë kibernetike (parandalimin e dhunës kibernetike).
- Njësia për parandalim në SPB Shkup, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq - Organizata Komunale Kisella Vodë, në prill të vitit 2021 filloi realizimin e projektit të mbështetur financiarisht nga Fondi për zhvillimin e projekteve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me titull - "Loja e fjalëve mund të lëndojë." Në lajmin shpërndahet informacioni për hapjen edhe të Zyrës për mbështetje psikosociale të viktimave të “cajber bulling”, mirëpo nuk arritëm të gjejmë informacion nëse ajo është funksionale apo jo.

<https://mvr.gov.mk/vest/15344>

- Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis”, duke iu përgjigjur ftesës publike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës më 6 korrik të vitit 2020 për Konsultim Publik për draft-versionin e Konceptit të arsimit në distancë, ka përgatitur mendimin si vijon në bazë të përvojave të deritanishme të tij dhe ekspertizës së specializuar:

"Mbrojtja e sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve

Mbrojtja e sigurisë së fëmijëve është e një rëndësie vendimtare për suksesin e gjithë reformës, e cila bazohet në promovimin e një vargu e të drejtave themelore të njeriut.

Rritja e përdorimit të teknologjive të bazuara në internet sjell edhe rritje të rreziqeve në fushën e sigurisë kibernetike (cybersecurity), dhunës moshatare onlajn (cyberbullying) si dhe varësisë nga interneti. Përballja me këto rreziqe duhet të fillojë me përfshirjen e tyre në debatin, rezultati i të cilit do të jenë dokumentet e ardhshme strategjike që do të paraqesin kornizën për organizimin e arsimit në distancë".

– Fragment nga mendimi i fondacionit dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

[<https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/prilog-na-fondacijata-metamorfozis-kon-javnata-konsultacija-za-nacrt-verzijata-na-koncepcijata-za-dalechinsko-obrazovanie/>](https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/prilog-na-fondacijata-metamorfozis-kon-javnata-konsultacija-za-nacrt-verzijata-na-koncepcijata-za-dalechinsko-obrazovanie/)

- Hulumtime/publikime në temën e dhunës kibernetike në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon

Më Maqedoninë e Veriut nuk janë gjetur hulumtime konkrete shkencore në temën e bullizmit kibernetik.

Publikime në temën – çfarë do të thotë dhunë kibernetike dhe parandalim – mund të hasen në internet (Publikime të caktuara ka në shtojcë të analizës më poshtë).

- Organizata joqeveritare - Gazetarët për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim dhe me mbështetjen e organizatës gjermane WWDP ka zhvilluar një pako-modulesh për parandalimin e dhunës: (dhuna moshatare, si të mbroheni nga dhuna moshatare, **dhuna në internet**, mobingi, si dhe modul për higjienën menstruale). Në modulin **dhuna në internet** flasim për termin dhunë kibernetike dhe parandalimin e vetë kësaj dukurie.

http://jhrmk.org/wp-content/uploads/2018/11/Modul_5_SAJBER-NASILSTVO.pdf

- Është mbajtur konferenca e-Shoqëri.mk me temën Përfshirja dhe efektiviteti – Qeverisja e mirë dhe interneti, që u mbajt më 25 dhe 26 nëntor të vitit 2020. Konferenca është nën patronazhin e Fondacionit për internet dhe shoqëri Metamorfozis. Në të njëjtën konferencë u mbajt edhe punëtori në temën: "Sfidat kryesore në digjitalizimin e arsimit në Maqedoninë e Veriut". Punëtorja kishte karakter të hapur dhe qëllimi i saj ishte të identifikonte rreziqet më të mëdha ndaj sigurisë dhe privatësisë në arsimin digjital. Punëtorja përbëhej nga një diskutim i përgjithshëm për të gjithë të prekurit në arsimin digjital, si dhe kërcënimet e zakonshme me të cilat përballen këta persona për çdo ditë. Është përdorur gjithashtu një vegël ndërvepruese mentimetër që pjesëmarrësit e kanë shfrytëzuar për të hartëzuar rreziqet dhe për t'u dhënë prioritet. Rreziqet më të mëdha janë identifikuar gjatë përdorimit të të dhënave biometrike dhe **bullingut onlajn (cyberbullying)**. Në punëtorinë kanë marrë pjesë rreth 50 pjesëmarrës.

https://metamorphosis.org.mk/aktivnosti_arhiva/kluchni-poraki-od-shesnaesettata-megjunarodna-konferencija-e-opshtestvo-mk/

- Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis ka përpunuar video në këtë temë.

https://metamorphosis.org.mk/multimedija_arhiva/shto-e-sa%d1%98ber-nasilstvo/

- Si pjesë e Projektit të lartpërmendur të BE-së, ndërsa të përpiluar nga Fondacioni Metamorfozis, Agjencia në faqen e saj të internetit ka publikuar edhe doracak për atë se çfarë paraqet **dhuna kibernetike** dhe mbrojtja prej saj.

<<https://dzlp.mk/sites/default/files/u1002/Sajbernasilstvo-II-izdanie.pdf>>

- Për [këtë temë](#) është shkruar që nga viti 2015 nga Boris Kuzmanov.
- Në vitin 2011 është botuar një broshurë me këtë temë nga dy autore të tjera, që është krijuar në kuadër të projektit Privatësia në internet në mënyrë të lehtë, të financuar nga Instituti Shoqëria e Hapur dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni.